



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË



Thirrje për mobilitet stafi për trajnim në kuadër të Programit Erasmus+ për komponentin KA1 në Universitetin e Ondokuz Mayıs University

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", në bashkëpunim me Universitetin **Ondokuz Mayıs University** në kuadër të Programit Erasmus+ për komponentin KA1, fton stafin akademik të punësuar me kontratë me afat të pacaktuar në UV, të aplikojnë për të përfituar një bursë për trajnim për një periudhë prej **5+2 ditësh**.

Periudha kur do të kryhet mobiliteti: **11-15 Mars 2019 ose 15-19 April 2019** (stafi mund të zgjedhë një nga dy periudhat e dhëna).

- Shpenzimet do të mbulohen nga skema Erasmus +, komponenti KA1 për mobilitet stafi. Ato parashikojnë:
 - Shumën prej **140 Euro/ditë** për mbeshtetje individuale.
 - Shpenzimet e udhëtimit: vlerë e përcaktuar në bazë të largësisë midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Përlllogaritja e largësisë bëhet në lidhjen e mëposhtme:

http://ec.europa.eu/programm.../erasmus-plus/.../distance_en.htm

Numri i bursave për trajnim: 1 (një)

Kriteret për aplikantët:

- Të jetë staf akademik i punësuar me kontratë me afat të pacaktuar në UV;
- Të jetë i fushave Gjuhë Angleze, Administrim Biznesi, Teknologji Informacioni, Inxhinieri Elektrike, Inxhinieri Mekanike, Infermieri e Përgjithshme dhe Infermieri Mami;
- Të ketë përvojë dhe kontribute akademike dhe shkencore në fushat e sipërpërmendura;
- Preferohet të jetë staf me gradë shkencore;
- Të argumentojë qartazi qëllimin e vizitës, planin e punës në institucionin pritës.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Titulli/ grada shkencore
- Prioritet i jepet stafit që nuk ka patur më parë eksperiencë mobilitetit.
- Njohja e gjuhës së huaj sipas nivelit të përcaktuar në marrëveshjen ndër-institucionale (minimumi i kërkuar niveli B2)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

- Kriteria të tjera shtesë mund të përfshijnë:
 - Motivimi
 - Vjetërsia në punë
 - Barazia gjinore (aty ku është e mundur të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formular aplikimi
- Kopje e dokumentit identifikues (pasaportë, ID);
- Dokument që vërteton statusin e të punësuarit pranë UV-së.
- CV vetjake në gjuhën angleze;
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohjen e gjuhës angleze (Përfshijm: stafi me diplomë universitare në gjuhë angleze).
- Vërtetim nga Rektori / Dekani i Fakultetit tuaj që ju lejon të shkëputeni për të kryer mobilitetin.
- Plani i mobilitetit

Dokumentet e aplikimit duhet të dorëzohen pranë Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë brenda datës **20/12/2018** ora **16:00**. Kandidatët fitues do të njoftohen prej Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në adresën e tyre të e-mailit.

Për përzgjedhjen e stafit ngrihet një komision, i cili vlerëson stafin në përputhje me kriteret e thirrjes.

Procesi i brendshëm i përzgjedhjes nuk garanton që mobiliteti do të kryhet. Përzgjedhja duhet të konfirmohet nga institucioni pritës përmes një letre pranimi.

Për më shumë informacion rreth skemës së mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit, vizitoni website e universitetit **Ondokuz Mayıs:** <http://erasmus.omu.edu.tr/en/genel/training-mobility> ose kontaktoni me Sektorin e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë: international@univlora.edu.al, ose pranë Rektoratit, Kati i I.

SUKSESE!